



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:009246

Datë: 11.04.2024

Numri i dokumentit: 05560290

**C.nr.1263/2023**

GJYKATA THEMELORE GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Artan Abazi, me bashkëpunëtorin profesionale Shkurte Kadriu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M. Th. nga ....., të cilin e përfaqëson me autorizim Fadil Sinanaj, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, Dr.”Shaban Geci”, në Kamenicë, me objekt kontesti kompensimin e pagës së trembëdhjetë, me vlerë të kontestit prej 377.00 €, jashtë seancës, më datën 11.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses M. Th. nga ..... dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Kamenicës – QKMF që paditëses, t’ia kompensoj në emër të pagës së trembëdhjetë, në vlerë të një page bazë, për vitin 2020, shumën prej 377.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, në vit, duke filluar nga data 29.12.2023 deri në pagesën përfundimtare, ne afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor

**II. DETYROHET** e paditura, që paditëses në emër të shpenzimeve të procedurës t’ia paguajë shumën prej 98.00 euro, në afat prej 7 ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

**A r s y e t i m**

Paditësja, përmes të autorizuarit të tij, me datën 29.12.2023, ka paraqitur padi kundër të paditurit me objekt kontesti për pagesën e pagesë së trembëdhjetë me vlerë të kontestit prej 377.00 €. Në padi paditësi ka theksuar se është në marrëdhënie pune te e paditura në pozitën e Infermieres në QKMF në Kamenicë. Baza ligjore lidhur me këtë kërkesë ka theksuar se është në Kontratën Kolektive Sektoriale (më tej: KKS), konkretisht në nenin 17 pargarfi 2, duke theksuar se “*Punëmarrësi ka të drejtë në kompensimin e pagës së 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit*”. Meqenëse e paditura nuk i ka paguar vullnetarisht mjetet të cilat ka qenë e obliguar t’i paguaj, paditësja kërkon nga gjykata që të aprovet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet e

paditura t'ia paguaj shumën prej 377.00euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e paraqitjes së padisë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar aq sa dalin deri në përfundim të këtij kontesti.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi, e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar në Raportin e Përmbledhjes së Kontrollit të Buxhetit të vitit 2020 për Shërbimet e Kujdesit Primar Shendetësor në Kamenicë, e paditura nuk ka mundësi buxhetore në përmbushjen apo kompensimin e pagës së 13-të, për punëtorët shëndetësor në kategorin e pagave, po ashtu ka theksuar se e paditura nuk është nënshkruese e KKS e nga ky fakt nuk ka legjitimitet real pasiv, me tutje ka cituar praktikën e Gjykatës së Apelit si dhe ka shtuar se në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (më tej: LPK) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë.

Gjykata, duke pasur parasysh faktin se e paditura i ka pohuar faktet vendimtare si dhe nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë, përveç që është thirrur në mungesë të mjeteve buxhetore, parashkrim dhe mungesë të legjitimitetit, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara, konform nenit 398 të LPK-ës.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritore në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se *“kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga e paditura, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësit është në mardhënie të punës tek e paditura, dhe se Kontrata Kolektive Sektoriale me nr. 05-3815 e datës 12.06.2018 në nenin 17, pika 2 i saj, e ka rregulluar këtë materie, pasi që në nenin përkatës shprehimisht është përcaktuar se *“Punëmarrësi ka të drejtë në kompesnimin e pagës së 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit*.

Pretendimet e të paditurës, se të njëjtit nuk janë palë nënshkruese të Kontrates Kolektive të Sektoriale dhe për të padituren nuk paraqet ndonjë detyrim, duke konsideruar se nuk kanë legjitimitet real pasiv në këtë çështje juridike kontestimore dhe e njëjta të refuzohet si e tillë, për faktin se paditësi nuk ka arritur ta vërtetojë kërkesëpadinë e tij, për gjykatën këto pretendime ishin të pa bazuara, për faktin se nënshkruese të kësaj kontrate janë MASHT dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, ndërsa në nenin 4, të kësaj kontrate, theksohet se *“KKS gjen zbatim në rregullimin e raporteve juridike për të gjithë të punësuarit*

*nëpër institucionet shëndetësore, duke përfshirë tri nivelet e sistemit shëndetësor, atë parësor, dytësor dhe tretësor”, e nga ky fakt të gjitha Drejtoritë Komunale të Shëndetësisë, në Kosovë, janë të obliguara ta zbatojnë Kontratën Kolektive Sektoriale Shëndetësore të dt.12.06.2018, dhe me kohë të planifikojnë mjete buxhetore për këto raste, po ashtu duke u bazuar në nenin 4, paragrafi 2, të kësaj kontrate, paditësi hynë në kuadër të përfituesve të të drejtave që rrjedhin nga KKS. Ndërsa sa I përket pretendimit tjetër të paditues së këmi të bëjmë me parashkrim të kërkesave, një pretendim I tillë është I pa bazuar nga fakti se paditësi pagën e trembëdhjetë e kërkonë për vitin 2020, pra paga e trembëdhjetë kompenzohet në fund vitë, pra në fund të muajit të dymbëdhjetë, ndërsa padinë e ka paraqitur më dt.29.12.2023, andaj nisur nga rrethana të tilla rezulton se paditësi padinë e ka ushtruar brenda afatit ligjor prej tre /3/ viteve, pasi që sipas nenit 87 të Ligjit të Punës, në mënyrë shprehimore është paraparë se: “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës*”. Andaj, përgjegjësia për kompensimin e pagës së trembëdhjetë është te e paditura, respektivisht të DSH-së, në Kamenicë.*

Gjykata për kamatën ligjore ka vendosur duke u bazuar në dispoziten e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
**C.nr.1263/2023, më datë 11.04.2024**

**Gjyqtari,**  
**Artan Abazi d,v**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.